

SHFK “NAIM FRASHËRI”NEGOTINË

KODEKSI I MËSIMDHËNËSVE

- ❖ Mësimdhënësi duhet të kujdeset për gjithë hapsirën e shkollës dhe pronën, në mënyrë të veçant për klasën ose kabinetin ku mban mësim;
- ❖ Mësimdhënësi çdo herë duhet të përkushtohet për të afirmuar lëndën e tij;
- ❖ Mësimdhënësi është i obliguar që të vijë më së paku 15 minuta para fillimit të orës mësimore, kurse mësimdhënësi kujdestar 20 minuta;
- ❖ Mësimdhënësi duhet ta respektoj kohëzgjatjen e orës mësimore (është e ndaluar vonesa në orë dhe dalja para kohe nga ora mësimore);
- ❖ Mësimdhënësi duhet ti evidentojë nxënësit që mungojnë në fillim të orës mësimore dhe atë ta bëj rregullisht;
- ❖ Mësimdhënësi çdo herë dhe çdo kund duhet të kujdeset për mënyrën e komunikimit, ai duhet të jetë i qartë dhe i kapshëm;
- ❖ Mësimdhënësi, në veçanti në orë mësimore, duhet ta përdor Gjuhën Letrare Shqipe;
- ❖ Mësimdhënësi duhet çdo herë të jetë shembull me dukjen e tij (në mënyrë të obliguar të ketë veshje pune) dhe sjelljen e tij;
- ❖ Mësimdhënësi nuk mund të tymos duhan në shkollë dhe në oborrin e shkollës;
- ❖ Çdo mësimdhënësi duhet në mënyrë profesionale duhet të përsoset duke ndjekur literaturë, ndjekje të seminareve, kurseve dhe shfrytëzimin e teknologjisë bashkëkohore;
- ❖ Mësimdhënësi është i obliguar të respektoj personalitetin e çdo nxënësi;
- ❖ Mësimdhënësi është i obliguar që në mënyrë profesionale të sillet në kohëzgjatje të orës mësimore;
- ❖ Mësimdhënësi është i obliguar në mënyrë të drejtë dhe reale ta notoj nxënësin për njohuritë e tij pa marrë parasysh notat e tjera;
- ❖ Mësimdhënësi duhet që ta lavdëroj çdo përparim të nxënësit;
- ❖ Mësimdhënësi duhet që insistoj që nxënësi në kohë dhe në mënyrë kualitative ti kryej detyrat e tij;
- ❖ Mësimdhënësi nuk mundet ta dënoj nxënësin në aspektin fizik dhe ta maltretoj psigjikisht;
- ❖ Mësimdhënësi është i obliguar që rregullisht ti ndihmoj nxënësit nëpërmjet llojeve të ndryshme të aktiviteteve;
- ❖ Secili mësimdhënësi duhet të insistoj që nxënësit në mënyrë të denjë dhe të disiplinuar të sillen në shkollë dhe jashtë saj;
- ❖ Mësimdhënësi duhet që rregullisht dhe në kohë ta thirë dhe informoj prindin për arrijtet, sjelljen dhe problemet e fëmijët të tij;
 - ❖ Mësimdhënësi duhet rregullisht të caktoj takim me prindërit dhe ti realizoj në orarin e takimeve me prindër;
 - ❖ Mësimdhënësi duhet ta udhëzoj prindërin në ndihmë nga persona kompetent në situata kur për atë ka nevojë;
 - ❖ Mësimdhënësi duhet ta respektoj çdo kolegë, të bashkëpunoj, shkëmbej mendime dhe përvoja të lidhura me punën;
 - ❖ Mësimdhënësi duhet të angazhohet në punën e aktivitetit profesional ku edhe ai vet i takon;;
 - ❖ Mësimdhënësi duhet rregullisht të marrë pjesë në punën e këshillit të paraleleve dhe të shkollës;
 - ❖ Mësimdhënësi duhet ti respektoj vendimet e këshillit të paraleles dhe këshillit të shkollës;
 - ❖ Mësimdhënësi duhet të jetë kreator e atmosferës së këndshme të punës dhe klimës pozitive emocionale në klasën e tij;
 - ❖ Mësimdhënësi duhet të ndërtoj marrëdhënje të mirëkuptimit, respektimit me nxënësit dhe të punësuarve të tjerë;

KODEKSI I SJELLJES SË NXËNËSVE

Më këtë kodeks përshkruhen të drejtat dhe përgjegjësitë të nxënësve të rregullt të SHFK “NAIM FRASHËRI” Negotinë e Pollogut, me qëllim që të kenë një pasqyrë reale për rolin e tyre në shkollë

NXËNËSIT JANË TË DETYRUAR QË TU PËRMBAHEN RREGULLAVE SHKOLLORE DHE TI RESPEKTOJNË DISPOZITAT LIGJORE DHE VENDIMET QË MERË SHKOLLA.

NXËNËSI DHE SJELLJA E TIJ NË RAPORT ME MJEDISIN E PUNËS

Nxënësi është i obliguar që të respektoj këtë KODEKS

- Nxënësi është i obliguar që të kujdeset për higjienën në klasë, në godinën e shkollës, oborrin e shkollës dhe në hapsirën që është rreth shkollës..
- Nxënësit kujdestar në mënyrë të detyruar duhet të jenë në klasë gjatë kohës së pushimit dhe çdo dëm i shkaktuar gjatë kohës së pushimit dhe çdo ndryshim i pa dëshiruar menjëherë ta paraqesin te arsimtari kujdestar dhe kujdestari i klasës.... Dëmi i shkaktuar në mënyrë të qëllimshme nxënësi duhet ta kompensoj tre fishin e saj dhe të mare masën e merituar disiplinore.
- Është e ndaluar futja edhe përdorimi i drogës, alkoolit, mjeteve piroteknike dhe mjeteve të tjera me të cilat cenohet siguria në dhe jashtë shkollës e nxënësit, në të kundërtën nxënësi mer masën pedagogjike -largim nga shkolla.
- Ndalohet konsumimi i ushqimit në mësojtore.
- Ndalohet mbajtja dhe përdorimi i telefonave celular gjatë procesit mësimor.
- Ndalohet konsumim i duhani në shkollë dhe në oborrin e shkollës.
- Nxënësi duhet të jetë i veshur siç duhet, me veshje e cila mbulon, dhe jo me pantallona të shkurta, të grisura dhe me mini funde, në raste të këtilla nxënësi duhet të largohet nga mësimi dhe të udhëzohet për të nderuar veshjen..
- Secili dëm i qëllimshëm kompensohet, nëse dëmtuese dihet në të kundërtën kompensohet me mjetet që do mbliidhen nga fondi solidar i të gjithë klasës.

NXËNËSI DHE ROLI I TIJ NDAJ MËSIMDHËNËSIT DHE NDAJ NXËNËSVE TË TJERË

- Nxënësi ka të drejtë të parashtroj pyetje për gjithçka që nuk i është e qartë nga materejali mësimor
- Nxënësi duhet të ketë kulturë komunikimi gjatë kohës së orës mësimore dhe ta ndjek me vëmendje mësimdhënësin dhe nxënësit e tjerë
- Në përgjigjet e tij, komente dhe vërejtje të përdor shprehje të qarta dhe jo dy kuptimshme nga gjuha letrare shqipe
- Gjatë komunikimit në klasë me mësimdhënësin të flasë në Gjuhën Letrare Shqipe
- Ka të drejtë ta shpreh pakënaqësinë e tij për notën e fituar, por në mënyrë të kulturuar dhe të mos e lëndoj dinjitetin dhe krenarinë e mësimdhënësit.
- Ta respektoj personalitetin e mësimdhënësit, shokut të klasës, dhe të të punësuarve të tjerë në shkollë, pavarësisht aftësive, statusit social, gjinisë, fesë dhe përkatësisë fetare.
- Të mës përdor shprehje të shëmtuara, fyese, ofenduese dhe vullgare të cilat nuk i kanë hije një cilit do nxënës, dhe si pasojë çdo herë sjellin papërkulshmëri.
- Të vlerësoj njohuritë të shokëve të klaës, si dhe të mos i nënçmoj të tjerët në klasë dhe jashtë saj...
- Ti respektoj qëndrimet e të tjerëve edhe atëherë kur ato janë të ndryshëm nga të tijët
- Të jetë i përgaditur ti ndihmoj shokut të klasës kur ai është në vështirësi, kur ka vështirësi në mësim, të solidarizohet me nxënësit të cilët kanë probleme shëndetësore dhe sociale.
- **Me mirësjellje tu tregoj shokëve të klasës për gabimet nga këndvështrimi pozitiv dhe fytyrën e sh nxënësit dhe shkollës.**
- **Nxënësi mund të kërkoj ndihmë nga mësimdhënësi ose bashkëpunëtori profesional, pedagogu, psikologu në tejkalimin e dilemave të theksuara dhe problemeve në jetën e përditshme lidhur me mësimin.**

NXËNËSI DHE MARËDHËNIA E TIJ ME MËSIMIN

Nxënësi është i obliguar që rregullisht dhe në kohë të vij në mësim, të jetë në shkollë 15 minuta para fillimit të mësimi. Mësimi fillon në ora07:20 dhe mbaron në ora12:55 kurse për klasët e para fillon në ora 12:00 dhe mbaron në ora 15:45.Nxënësit kanë pushim të madh midis orës dytë dhe tretë në kohëzgjatje prej 30 min. Gjatë pushimeve të vogla nxënësit janë të obliguar që mos e lëshojnë klasën, dmth të jenë në klasë dhe të ulur nëpër banka kur të filloj ora mësimore.

- Hyrja e nxënësve në godinën e shkollës është në hyrjen kryesore kurse në oborr nga dy anë.
- Nga nxënësi pritet që gjithmonë të jetë i përgaditur për mësim.
- Në mënyrë kritike ti vlerësoj të arriturat e veta.
- Të mos e prish punën e planifikuar në orë mësimore me vonesë , bisedë ose çfarë do lloj situatë të tjetër konfliktuoze..
- Nuk janë të lejuara njoftime për festa dhe ahengje në vendin për shpallje ose gjatë orëve mësimore.
-

ËSHTË MIRË NXËNËSI TË JETË ANËTAR OSE PJESMARËS I NDOJËRIT PREJ AKTIVITETEVE TË LIRË, NË VARSHMËRI NGA INTERESI DHE AFTËSITË INDIVIDUALE TË NXËNËSIT

- Nxënësit nuk është e lejuar që të përtyp çamçakëz gjatë orës mësimore. Është e ndaluar me dispozit ligjore çdo lloj organizimi politik dhe fetar në shkollë
- Orët zgjasin 40 minuta.
- Çdo vonesë ose mungesë e qëllimshme në orë mësimore, kujdestari i klasës mungesën e shënon si të pa aesyeshme.
- Për çdo mungesë të nxënësit nga mësimi, prindëri është i obliguar ta informoj kujdestarin e klasës për arsyen e mungesës.
- Për mungesat pa leje dhe shkelje të tjera të detyrimeve dhe mos plotësimit të detyrimeve shqiptohen masat e më poshtme pedagogjike:

- vërejtje me gojë
- vërejtje me shkrim
- ulje të sjelljes
- transferim në klasë tjetër
- transferim në shkollë tjetër.

- Nxënësi me tre ose më tepër nota të dobëta e përsërit klasën.
- Nxënësi që ka bërë një të tretën e e mungesave me leje dhe pa leje nga numri i përgjithshëm i fondit të orëve në lëndë të caktuara mësimore të vërtetuara me plan program mësimor i nënshtrohet provimeve klasore në qershor dhe gusht.

Drejtori:
Afërdita Hoda_____



Kodeksi i prindërve

Të respektohet rendi shtëpiak i shkollës dhe në kohën e orëve mësimore të mos futen në shkollë;

Ndalohet hyrja me vetura në oborrin e shkollës;

Çdo prind të paraqitet te hyrja e shkollës te nxënësi kujdestar dite;

Rregullisht informoheni për suksesin e arritur dhe sjelljen për fëmijën tuaj;

Rregullisht kryeni obligimet që i keni ndaj shkollës(obligimet matrejtale, arsyetimin e mungesave nga orët të nxënësve, konsultimet me mësimdhënësit dhe të ngjashme);

Në mënyrë obligative merni pjesë në takimet e prindërve në shkollë, dhe sipas nevojës edhe në ditët e takimeve me prindër të cilët i kanë caktuar kujdestarët e klasëve;

Keni në mendje se veprimet tuaja janë shembull për sjelljen e fëmijës suaj;

Shkolla është institucion edukativo-arsimor ku duhet të futeni me veshje serioze dhe të denjë;

SHFK “NAIM FRASHËRI”NEGOTINË

RENDI SHTËPIAK

RENDI SHTËPIAK

- Mësimi në shkollë realizohet ne 2 turne: turni i parë fillon në ora 7.30 dhe mbaron në ora 12:50, turni I dytë fillon në ora 13:00 dhe mbaron në ora 18:00
- Nxënësit janë te obliguar te vinë në oborrin e shkollës 20 minuta para se të filloj ora e parë.
- Rreshtimi I nxënësve bëhet në kohën kur bie zili para orës së parë.
- Nxënësit të rreshtuar hynë në shkollë me lejen e kujdestarëve të ditës.
- Nxënësit në oborrin dhe koridorin e shkollës të lëvizin në mënyrë të disiplinuar (të mos vrapojnë, mos bërtasin, mos përleshen dhe mos bëjnë as gjë qe e çrregullon rendin e shkollës).
- Nxënësit mos të rrinë nëpër koridore gjatë orës së mësimi.
- Çdo paralele duhet te kujdeset për klasën dhe kudo ku lëvizin (sallën e edukatës fizike, informatik, koridore etj).
- Në mes të orëve, kur nuk ka pushim, nxënësit janë të obliguar tëp resin arsimtarin të lëndës që pason.
- Nxënësit nuk kanë te drejtë të futen në orë pas arsimarit.
- Pushimi I gjatë është pas orës së tretë te cikli I lartë ,kurse te cikli i ulët pasë orës së dytë dhe zgjat 20 minuta.
- Gjatë kohës së pushimit, nxënësit dalin në oborrin e shkollës por ne raste të motit të lig, ata qëndrojnë mbrenda në shkollë.
- Disciplina e nxënësve duhet të jetë shembullore
- Arsimtarët kujdestar janë të obliguar të mbajnë kujdestarinë në vende të caktuara me orarë.
- Nxënësit duhet ti respektojnë marrëdhënietndëretnike dhe të respektohen mes veti.
- Kujdestarët kujdesen për rendin, disiplinën dhe higjenën në klasë dhe I paraqet dëmet e bëra ose nxënësit e pasjellshëm te arsimatrët kujdestarë.
- Çdo nxënës është I obliguar ta ruaj inventarin e shkollës.
- Çdo nxënës është I obliguar të kontribuoj për kujdesin ekologjik të oborrit të shkollës dhe objektin e shkollës.
- Çdo nxënës që do të dëmtojë shkollën ose oborrin e shkollës, është I obliguar të njëjtë ta kompensojë.
- Pas mbarimit të mësimi, nxënësit pa zhurmë dalin prej klase me arsimtarin deri te dalja e shkollës.
- Ndalohet qëndrimi I nxënësve në shkollë dhe oborrin e shkollës pas mbarimit të mësimi.
- Nxënësit gjat rrugës prej shkolle në shtëpi dhe anasjelltas duhet të jenë më të sjellshëm, të disiplinuar, të kujdesshëm dhe ti respektojnë rregullat e komunikacionit me çka do të kontribuojnë për sigurinë në komunikacion.
- Ndaj nxënësve të cilët nuk do ti respektojnë kërkesat e rendit shtëpiak, do të merren masa pedagogjike, në pajtim me Rregulloren e shkollës.
- Ekzemplarë nga “RENDI SHTËPIAK” do të ketë në çdo klasë.

DREJTOR: Afrdita Hoda

EKO KODEKSI

**Natyrë është nëna e cila na ushqen!
Natyrë është nëna pa asnjë mangësi!**

- ✿ Hudhni mbeturinat, në shport të zbrazur!
- ✿ Bari të lut, mos shkil, më dhemb!
- ✿ Në kopësht mbill lule, që ti përkasësh kësaj bote!
- ✿ Uji në jetë është shumë i rëndësishëm- prandaj ruaje që të mos jetë i pikëlluar!
- ✿ Lampa ekologjike vlenë- energji elektrike për ty kursen!
- ✿ Kush mbart qese ekologjike- kur shkon në treg nuk lyp!
- ✿ Në ajër më pengon- kur qesja plastike fluturon!
- ✿ Natyrë e pastër duhet të ruan!
- ✿ Të gjithë njerëzit duhet të dinë, që pastaj të mos pendohen!
- ✿ Për të ardhmen tonë faktor janë të gjithë!
- ✿ Bëju ekologjist që pa shqetësim të të kalojnë ditët!
- ✿ Mos e prish natyrën- porosija e jonë është e zëshme dhe për të gjithë njerëzit është e kuptueshme!

KODI I VESHJES

Kodi i veshjes i referohet veshjeve që duhet të veshin nxënësit gjatë shkollës kohës që janë të pranishëm në shkollë. Ky kod ka të bëjë me dhënien e një përshtypjeje shembullore për të gjithë nxënësit. Ajo gjithashtu ofron siguri dhe shembull për shkollën në mjedis. Shkolla jonë nga nxënësit ka pritshmëri të mëdha jo vetëm për arritjet por edhe për sjelljen (prezantimin personal)

*** Është e ndaluar të vishni pantallona të shkurtra vajza dhe djem;**

*** Ndalohet veshja e bluzave të shkurtra;**

*** Është e ndaluar të vishni xhinse të grisura;**

*** Ndalohet veshja e bluzave që nuk i mbulojnë s**

*** Është e ndaluar të vendosni bizhuteri të çmuara, vathë në veshë dhe hund tek djemtë**

*** Ndalohet mbajtja e celularëve;**

*** Rrobat duhet të jenë të rregullta dhe të pastra;**

*** Kushtojini vëmendje higjienës personale:**

*** Modelet e flokëve ekstreme dhe flokët e çrregullt janë të ndaluara tek vajzat dhe djemt;**

*** Ndalohet ardhja në shkollë me thonj të llakuar me gjatësi të papërshtatshme;**

